

BASHKIA TEPELENË
NJOFTIM PËR DHËNIEN ME QIRA

Në zbatim të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar; Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Vendimin Nr. 559, datë 29.07.2022 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve” të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 9.6.2016 “Për rregullat e procedurat e kërkit, shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullësor publik”, si dhe VKM-së Nr. 433 date 08.06.2016 “Për Transferimin në Pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të kullotave Publike” të ndryshuar; VKB nr.38 datë 29.03.2023 “Për shprehjen e pëlqimit në parim për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullësor ndodhur në Bashkinë Tepelenë”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë:

NJOFTIM:

1. Fillimin e procedurave të dhënies me qira me anë të konkurrimit të pasurisë së llojit “Pyll” me formë qeverisjeje “Tokë me bimësi pyjore” me sipërfaqe 0.01 ha, nënngastra 20b Ekonomia Pyjore Kurvelesh, ndodhur në fshatin Gusmar, Njësia Administrative Kurvelesh/Bashkia Tepelenë.

Qëllimi i përdorimit do të jetë “për vendosje antene të telefonisë fikse”.

Afati i kontratës së qirasë është deri në 9 vjet në përputhje me afatin e planit të mbarështimit.

Çmimi dysHEME do të jetë në zbatim të Vendimit Nr. 559, datë 29.07.2022 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve” të ndryshuar, duke filluar nga 5’500’000 lekë/ha/vit.

Vlerësimi i konkurrentëve do të bëhet sipas këtyre pikave:

- Plani i biznesit dhe investimet 40 pikë
- Niveli i punësimit 10 pikë
- Masa e qirasë për ha/vit 50 pikë

Tërheqja e dokumentacionit të nevojshëm do të bëhet pranë Bashkisë Tepelenë.

Paraqitja e dokumentacionit do të bëhet në datën 12.01.2026 ora 10:00 në zyrën e protokollit të Bashkisë Tepelenë dhe konkurimi do të vijojë në sallën e mbledhjeve.

Dokumentacioni që duhet të plotësohet nga konkurentët për konkurim është:

- a) Kërkesën e operatorit së bashku me gjeneralitetet e tyre.
- b) Ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë.
- c) Projektin Teknik të hartuar nga specialist të licencuar ku janë trajtuar të gjithë elementët e nevojshëm për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar.
- d) Planbiznesi i hollësishëm, ku të përshkruhen qartë:
 - Plani i punësimit, ndikimi i tij në rritjen e të punësuarve,
 - Plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen.
 - Të dhënat për kapacitetet teknike, stafin, makineri që zotëron, etj.
- e) Planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme.
- f) Ofertën e detyrimit vjetor të qirasë.
- g) Certifikatën e regjistrimit (NIPT) dhe ekstraktin historik të regjistrimit nga QKB të subjektit.
- h) Vërtetimin nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve që subjekti nuk ka detyrime tatimore.
- i) Vërtetimin nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale dhe nuk ka proces gjyqësor që lidhen me veprimtarinë që ushtron, për subjektin dhe administratorin e subjektit.

- j) Raport i ndikimit në mjedis.
- k) Vërtetim nga nga sektori i tatimeve Bashkia Tepelenë që subjekti nuk ka detyrime.
- l) Garanci të mjaftueshme për përballimin e investimit të parashikuar në planin e biznesit të dorëzuar (vërtetim nga banka).
- m) Deklarata mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme.

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noteruara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për shkualifikim.